



VENDIM

Nr.17 Date 06.03.2009

**PER MIRATIMIN E DISA SHITESAVE DHE NDRYSHIMEVE NE
RREGULLOREN PER KRITERET E DHENIES DHE HEQJES SE
STATUSIT TE KLIENTIT TE KUALIFIKUAR**

Në mbështetje të neneve 9, dhe 48 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 121 dhe 128 te Ligjit nr.8485, date 12.05.2008 “Kodi i Procedurave Administrative te Republikes se Shqiperise”, pikes 7 te Modelit te Tregut te Energjise Elektrike, te miratuar me VKM nr.338, date 19.03.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 06.03.2009, mbasi shqyrtoi propozimin e Drejtorise Juridike dhe Mbrojtjes se Konsumatorit si dhe te Drejtorise se Licensimit dhe Monitorimit te Tregut, per miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve ne Rregulloren per kriteret e dhenies dhe heqjes se statusit te Klientit te Kualifikuar ,

Vendosi :

1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve ne Rregulloren per kriteret e dhenies dhe heqjes se statusit te Klientit te Kualifikuar si me poshte:
 - A) Ne nenin 2, ne fillim te fjalise pas fjales te gjithe, hiqen fjalet kliente tarifore dhe vendoset fjala **subjektet**.
 - B) Ne nenin 3 behen keto ndryshime :

Pika 1 aty ku thuhet ERE ndryshon dhe behet: Enti Rregullator i Energjise.

Pas Pikes 3 shtohet pika 3/1 me permbajtjen:
3/1. Subjekt – Ne kuptim te kesaj rregullore do te thote nje person fizik ose juridik qe kerkon te perfitoje statusin e klientit te kualifikuar.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve



Pika 5 ndryshon dhe behet:

OSSH ” është personi i licencuar për të kryer veprimtarine e shpërndarjes se energjisë elektrike dhe ate te furnizimit publik me pakice.

Pika 6 ndryshon dhe behet:

OST është personi i licencuar për të kryer veprimtaritë e transmetimit të energjisë elektrike, dispeçerimit të sistemit elektroenergjetik, si dhe për operimin e tregut të energjisë elektrike.

Pika 7 shfuqizohet.

C) – Ne nenin 4 behen keto ndryshime:

Germa a) ndryshon dhe behet:

ploteson kriterin e vendosur vit pas viti nga Bordi i Komisionerve ne zbatim te nenit 48, pika 1

Germa b) ndryshon dhe behet:

Paraqet në ERE kopje të noterizuar të librezës së pagesave të energjisë elektrike dhe kopje të faturave të energjisë elektrike, të noterizuara, për vitin e mëparshëm, sipas të cilave ka likuiduar detyrimet ndaj OSSH deri në momentin që aplikon ne rastin e klienteve egsistues.

Germa c) ndryshon dhe behet:

Subjekti demonstroi në ERE, kategorine e klientit te ciles ai i perket apo do ti perkasi.

D) Ne nenin 5 behen keto shtesa dhe ndryshime:

Ne piken 1 ne fillim te fjalise behet:

Çdo subjekt egsisutes apo i prespektives,

Pika 2 shfuqizohet.

Pika 3 behet pika 2 dhe ka permbajten:

Brenda 20 diteve nga marrja e kerkeses, Bordi pasi kontaston rregullshmerine e aplikimit, vendos per dhenien ose jo te statusit te klientit te kualifikaur,

E) Ne nenin 6, behen keto ndryshime :

Ne piken 1 pas fjaleve duhet te njoftojte hiqet fjala “Furnizuesin” dhe vendoset OSSH,

ne piken 2 ne fund te fjalise shtohen fjalet:

dhe te njoftoje OSSH apo OST si dhe KESH/ FPSH dhe ERE-n.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve



F) Ne nenin 7 shfuqizohet germa b),

G) Ne nenin 8 ne piken 1 dhe 3 aty kthuhet furnizuesin publik, ndryshon dhe behet OSSH.

GJ) Nen nenin 10 ne titullin e neinit hde ne pargarfin e pare ku thuhet Furnizuein publik, behet OSSH/ Furnizuesi publik me pakice.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr. 17 Date 06.03.2009

**PER MIRATIMIN E DISA SHITESAVE DHE NDRYSHIMEVE NE
RREGULLOREN PER KRITERET E DHENIES DHE HEQJES SE
STATUSIT TE KLIENTIT TE KUALIFIKUAR**

Anëtarët e Bordit

| | Pro | Kundër |
|--------------------------|-------|--------|
| Bujar Nepravishta | _____ | _____ |
| Entela Shehaj | _____ | _____ |
| Ardian Haçi | _____ | _____ |
| Abaz Aliko | _____ | _____ |
| Shkelqim Bozgo | _____ | _____ |